




REPublika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot.:
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-3684/13</u>
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Prot. No. <u>01-3684/13</u>
Nr. i faq.:	Data:
Broj stranica	Datum
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>01-11-2013</u>
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.10.2013, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3035/13, për z. Sylejman Rexhepi. – U.d. i Drejtorit në Klinikën e Reumatologjisë, Aleregiologjisë me Imunologji Klinike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për Zyrtarin e Lartë, z. Sylejman Rexhepi, u.d. i Drejtorit në Klinikën e Reumatologjisë, Aleregiologjisë me Imunologji Klinike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Rexhepi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit ( me datë 08.10.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Rexhepi, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat dhe do të vazhdoj të ushtrij funksionin e tij publik.

Ndërkohë, z. Rexhepi ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë( DPKI.03- 3499/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në N.Sh. "Rheuma" për të ushtruar funksionin e tij publik si u.d. i Drejtorit në Klinikën e Reumatologjisë, Aleregiologjisë me Imunologji Klinike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, me çka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së ;
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

